



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN

Numri i lëndës: 2024:056471 C. nr. 982/2024
Datë: 20.01.2025
Numri i dokumentit: 06731611

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN, gjyqtari Atdhe Berisha, në çështjen juridike kontestimore të paditëses V.B. nga Prizreni, të cilën e përfaqëson sipas autorizimit av. S.K. nga Prishtina, kundër të paditurës Sh.S.K.U.K. – Spitali Rajonal – Prizren, për kompensimin e pagës shtesë për ditët e punës gjatë vikendit dhe rrezikshmërisë, më datë: 20 Janar 2025, merri këtë:

A K T V E N D I M

Hedhet poshtë padi në këtë çështje kontestimore.

A r s y e t i m

Paditësja V.B. përmes të autorizuarit të saj ka paraqitur padi për kompensimin e pagës shtesë për ditët e punës gjatë vikendit dhe rrezikshmërisë, kundër të paditurës Sh.S.K.U.K. – Spitali Rajonal – Prizren, me të cilën ka kërkuar nga gjykata të detyron palën e paditur, që për kohën kontestuese prej hyrjes në fuqi të ligjit e deri në plotfuqishmërinë e aktgjykimit, në emër të pagës shtesë për punën gjatë vikendit dhe rrezikshmërisë të kompensohet paditësi në shumë të cilën do ta precizonë pas marrjes së ekspertizës financiare, me kamatë ligjore prej 8 % nga dita e shkaktimit të dëmit e gjerë në pagesën definitive dhe atë në afat prej 7 ditësh nga dita plotfuqishmërisë së aktgjykimit nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm. Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar. Në dispozitiv nuk e ka përcaktuar vlerën e shumës për të cilën kërkon për shkak të kompensimit të pagës shtesë për ditët e punës gjatë vikendit dhe rrezikshmërisë.

Pasi që pala paditëse nuk ka paraqitur shumën e kompensimit të pagës shtesë për ditët e punës gjatë vikendeve dhe rrezikshmërisë, për të cilat kërkon kompensimi, gjykata me Aktvendim C. nr.982/2024 datë 17 dhjetor 2024, ka kërkuar nga pala paditëse plotësimin e padisë në afat prej 3 ditësh, duke e njoftuar palën paditëse për pasojat e mosveprimit sipas atij aktvendimi.

Përkundër faktit që pala paditëse e ka pranuar aktvendimin e lartcekur, ajo me parashtrësën e datës 26 dhjetor 2024, për plotësimin dhe përmirësimin e padisë nuk e ka bërë precizimin sa i përket ditëve të punës gjatë vikendit, sa ditë ka punuar dhe për cilën periudhë kohore kërkohet kompensimi në emër të rrezikshmërisë, por i kaka propozuar gjykatës që plotësimin dhe përmirësimin e padisë për ditët e punës gjatë vikendit dhe për periudhën kohore apo prezencën në punë, do ta bëjë pas nxjerrjes së ekspertizës me arsyetimin se tani është e pamundur.

Në kuptim të nenit 99 par. 2 lidhur me nenin 254 dhe 391 të LPK-së, parashihet që padia duhet të jetë e kuptueshme dhe të përmban çdo gjë që nevojitet sipas sajë, kur paditësi me padi kërkon ekzistimin e një të drejte që i takon.

Në rastin konkretë pala paditëse kërkon kompensim të pagës shtesë për ditët e punës gjatë vikendit dhe rrezikshmërisë, mirëpo paditësja përmes të autorizuarit të sajë përkundër pranimit të vendimit për përmirësim dhe plotësim të padisë, nuk i ka përcaktuar për sa ditë pune dhe për cilën periudhë kohore kërkon kompensimin. Mbi këtë bazë gjykata nuk ka mundur të vepron sipas padisë dhe precizimit të pa përmirësuar, pasi që në mënyrën si është paraqitur kërkesa, pala e paditur nuk mund të deklarohej në përgjigjen në padi që do ta paraqiste e cila do të detyrohej nga gjykata që brenda afatit të caktuar të paraqet përgjigje në padi. Për të cilën gjë do të lindnin pasoja për palën e paditur.

Pasi që pala paditëse përkundër faktit që gjykata ka kërkuar përmirësimin dhe plotësimin e padisë, nuk ka vepruar sipas atij aktvendimi. Përkundrazi, me parashtrësën për plotësimin e padisë ajo nuk ka plotësuar dhe përmirësuar padinë. Gjykata në kuptim të nenit 391 par. 1 germa (g), të LPK-së vendosi të hedh poshtë padinë.

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN
C. nr.982/2024 datë 20 Janar 2025

Gj y q t a r i,
Atdhe Berisha

UDHËZIME PËR ANKESË: Kundër këtij aktvendimi, pala e pakënaqur mund të ushtron ankesë në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, përmes kësaj gjykate, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh, nga dita e pranimit të këtij aktvendimi.